

Pyetja 1.

Troja e Iliadës ka qenë:

- qytet historik
- person real
- vend imagjativ
- kështjellë mitologjike

Pyetja 2.

Në thelb të Iliadës është:

- kthimi i luftëtarëve grekë në atdhe
- lufta që bënë grekët për të plaçkitur Trojën
- hakmarrja për shkak të rrëmbimit të mbrëtëreshës së Spartës
- luftrat e akejve dhe eolëve për Trojën

Pyetja 3.

Në cilën nga veprat e mëposhtme vargjet fillojnë “in media res” (ritardato):

- Iliada
- Eneida
- Odisea
- Medea

Pyetja 4.

Perënditë në poemat homerike janë:

- të humanizuara
- të shenjta
- mistike
- ireale

Pyetja 5.

Odisea vlerësohet si:

- historia e parë e dashurisë në letërsinë greke
- libri i parë me aventura
- poema me strukturë të përkryer
- vepra që mbështetet tërësisht në mitologjinë greko-romake

Pyetja 6.

përsëritja (si figurë) te poema e Homerit Iliada ka të bëjë me:

- thelbin epik të saj
- kohën e domosdoshme përgatitore për veprim
- stilin e autorit
- oralitetin e veprës

Pyetja 7.

Tek Odisea elementet për krahasimet poeti i merr kryesisht nga:

- dukuritë e natyrës
- sfera shpirtërore
- bota mitologjike
- skenat e luftimeve

Pyetja 8.

Iliada karakterizohet nga përdorimi i:

- simboleve dhe paralelizmave
- krahasimeve dhe paralelizmave
- antitezave dhe ironisë
- enumeracioneve dhe inversioneve

Pyetja 9.

Poemat homerike ndikuan te Virgjili veçanërisht në:

- përmbajtjen heroike
- emancipimin qytetar të njerëzve
- anën kompozicionale
- në ndërtimin e heronjve kryesorë

Pyetja 10.

Në qendër të veprës së Hesiodit është:

- ndërtimi i realitetit model
- realiteti i jetës së përditshme
- konflikti familjar
- ndërtimi i demokracisë athinase

Pyetja 11.

Në veprën *Punët e ditët*, Hesiodi i konkretizon parimet e përgjithshme përmes figurës së:

- Zeusit
- Persit

B.Uranit

- Erosit

Pyetja 12.

Punët e ditët si dhe poemat homerike është shkruar në:

- dialektin jonian

- eolian
- dorian
- e zonave të Egjeut

Pyetja 13.

Vepra e Hesiodit spikat për:

- shtratin filozofiko-mistik
- shtresën politiko-fetare
- këshillat praktike
- krijimin e realitetit mitologjik

Pyetja 14.

Safo lëvroi:

- lirikën monodike
- elegjinë
- lirikën korale
- poezinë jambike

Pyetja 15.

Poezia e Safos dallon për:

- pikturimin e natyrës
- paraqitjen e realitetit të përditshëm
- shprehjen e emocioneve të brendshme
- krijimin e personazheve realë

Pyetja 16.

Nga shumë tragjedi të Eskilit na kanë mbërritur vetëm:

- 12 vepra
- 27 vepra
- 7 vepra
- 3 vepra

Pyetja 17.

Qëndrimin e tij prej humanisti Eskili e shpreh qartë te:

- Persët
- Prometeu i lidhur
- Orestia
- Agamemnoni

Pyetja 18.

Prometeu çlirohet nga:

- Zeusi
- Oqeanidet
- nimfat
- Herakli

Pyetja 19.

Figura e Prometeut karakterizohet nga:

- hakmarrja
- dashuria për njerëzit
- kompleksi i Edipit
- misioni hyjnor

Pyetja 20.

Në tragjedinë e tij Eskili paraqet:

- fatin e individit
- pushtetin e perëndive
- fatin e fisit (shoqërisë)
- fajin mitik

Pyetja 21.

Prometeu i Eskilit dallon për:

- karakterin emotiv
- karakterin altruist
- karakterin pasiv
- karakterin monolit

Pyetja 22.

Subjekti i tragjedisë *Edipi mbret* është marrë nga:

- cikli teban i miteve
- historia greke e shek. V-IV p.e.s.
- cikli mitologjik mbi atridët
- historia e azisë së Vogël

Pyetja 23.

Në veprimet e saj Antigona udhëhiqet nga:

- ligjet e shkruara, shtetërore
- ligjet e pashkruara, fetare
- urrejtja ndaj Kreontit
- dashuria për Etioklin

Pyetja 24.

Cilësohet si vepër me strukturë të përsosur:

- Edipi mbret
- Edipi në kolonë
- Antigona
- Filokteti

Pyetja 25.

Sofokliu e çoi edhe më tutje veprën e krijuar nga Eskili sepse:

- heronjtë e Sofokliut veprojnë në mënyrë më të pavarur
- heronjtë e Sofokliut përcaktojnë vetë sjelljen e tyre në marrëdhënie me njerëzit
- hyjnitë futen më rrallë në skenë
- të trija alternativat e shënuara

Pyetja 26.

Subjekti i Medeas është marrë nga:

- periudha e dekompozimit të shtetit demokratik skllavopronar
- legjendat heroike
- cikli mitologjik i legjendave mbi argonautët
- miti i hebreat endacak

Pyetja 27.

Medean e karakterizon lufta e brendshme midis:

- etjes për pasuri dhe hakmarrjes
- etjes për hakmarrje dhe dashurisë për fëmijët
- etjes për pushtet dhe xhelozisë bashkëshortore
- dashurisë për Jasonin dhe urrejtjes për Kreontin

Pyetja 28.

Kori në teatrin antik:

- përcjell mesazhe
- merr pjesë në veprim
- është kornizë e jashtme
- nuk ka ndonjë rol

Pyetja 29.

Në *Poetikën* e Aristoelit trajtohen çështje të rëndësishme të:

- estetikës dhe teorisë së artit
- informimit dhe teorive të komunikimit
- analizës së tekstit dhe letërsisë greko-romake

- letërsisë dhe arteve pamore

Pyetja 30.

Aristoteli e quan poezinë:

- histori
- imitim
- rrëfm
- krijim

Pyetja 31.

Katarsisi Aristotelian është një katarsis:

- estetik
- filozofik
- etik
- artistik

Pyetja 32.

Pjesën kryesore të *Poetikës* së Aristotelit e përbën teoria mbi:

- komedinë
- tragjedinë
- lirikën
- epikën

Pyetja 33.

“peripeci” sipas Aristotelit ka të bëjë me:

- përsëritjen periodike të situatave
- parimin e mozaikut për fabulat e ndërlikuara
- konfliktin e personazheve në raport me njëri-tjetrin
- kthesën e papritur që marrin ngjarjet

Pyetja 34.

Eneida e Virgjilit cilësohet si:

- poema model e antikitetit greko-romak
- monument lavdie e atdheut të poetit
- sublimim i Iliadës së Homerit
- historia mitike e Romës

Pyetja 35.

Eneida përbëhet nga 12 këngë që:

- ndahen në 2 pjesë

- ndahen në 3 pjesë
- ndahen në 4 pjesë
- nuk ndahen në pjesë

Pyetja 36.

Në pjesën e parë të Eneidës zotëron:

- toni epik
- shtresa historiko-legjendare
- linja e dashurisë
- fryma lirike

Pyetja 37.

Epopeja e Virgjilit *Eneida* flet për :

- zanafillën legjendare të Romës së lashë
- krijimin e perandorisë romake
- fatin e individit nën pushtetin e perëndive
- shoqërinë romake të shek. I p.e.s.

Pyetja 38.

Si model poetik për poemën e Virgjilit ka shërbyer:

- Antigona dhe Edipi mbret i Sofokliut
- Mbi natyrën e Lukrecit
- Elektra dhe Medea e Euripidit
- Iliada dhe Odisea e Homerit

Pyetja 39.

Cilësohet si modeli klasik i poemës romantike:

- Eugjen Onjegini - Pushkini
- Orientalet - Hygoi
- Shtegtimet e Çajld Haroldit – Bajron
- Libri i këngëve – Hajne

Pyetja 40.

Shtegtimet e Çajld Haroldit është një poemë:

- liriko-epike - epiko-lirike
- dramatike
- satirike

Pyetja 41.

Bajroni shquhet për:

- përdorimin e alegorisë
- strukturën e njesuar
- thelbin epik
- gjuhën lakonike

Pyetja 42.

Çajld Haroldi ëhtë ndërtuar në strofa 9-vargëshe që në letërsinë angleze njihen si:

- strofa spenseriane
- strofa romanatike
- strofa elizabetiane
- strofa moderne

Pyetja 43.

Përshkrime dhe tablo udhëtimesh është tipar i:

- Ata Troli
- Libri i këngëve
- Gjermania përrallë dimri
- Deti i Veriut

Pyetja 44.

“Zonja Bovari” e Floberit ka si nëntitull:

- Një histori dashurie
- Zakone të jetës provinciale
- Dashuri tragjike
- përralla pariziene

Pyetja 45.

Romani i Floberit “Zonja Bovari” i vendos ngjarjet në:

- Paris
- plazh
- provincë
- Lion

Pyetja 46.

Cili shkrimtar u padit për imoralitet pas botimit të veprës së tij:

- Trebeshina
- Hygoi
- Floberi
- Camaj

Pyetja 47.

Nga vëllimet poetike të Hygoit dallohet për sarkazmin therës:

- Ode
- Ode dhe balada
- Orientalet
- Ndëshkimet

Pyetja 48.

Të mjerët e Hygoit është shkruar sipas:

- modeli të romanit romantik
- tipit të romanit fejton
- modelit të romanit socio-politik
- modelit të prozes realiste

Pyetja 49.

Gjermania është vendlindja e:

- realizmit
- klasicizmit
- simbolizmit
- romantizmit

Pyetja 50.

Poezia e Hajnes mbështetet fort në:

- traditën e poezisë angleze
- traditën e poezisë popullore
- poezinë gjermane të shek. XIX
- ngjarjet e revolucionit francez

Pyetja 51.

“Kantot” e Leopardit dallojnë për:

- respektimin e formave klasike të metrikës
- përdorimin e vargut të lirë
- mbështetjen në metrikën popullore
- rrëfimin lirik

Pyetja 52.

Poezia e Leopardit është një poezi:

- intelektuale
- arkaike
- tregimtare
- vizuale

Pyetja 53.

Meqë trajtat e sendeve janë mjaft të papërcaktuara dhe fantazia e plotëson botën sipas dëshirës së tij, Leopardi parapëlqen:

- shiun
- natën
- ditën
- diellin

Pyetja 54.

Tatjana e veprës Eugjen Onjegini mishëron:

- femrën materialiste
- përkryerjen fizike
- idealin moral
- fajin mitik

Pyetja 55.

Narracioni të *Eugjen Onjegini* ka karakter:

- epik
- lirik
- dramatik
- epiko-lirik

Pyetja 56.

Ndjenja kryesore që përcjell Eugjen Onjegini është:

- gëzimi
- urrejtja
- trishtimi
- mëshira

Pyetja 57.

Synonte të krijonte “tablonë e jetës së zakonshme”:

- Leopardi
- Kamy
- Eskili
- Balzaku

Pyetja 58.

Historia e njeriut që arrin mirëqenien pa shumë mundime përfaqësohet nga:

- Rastinjaku
- Grandeja

- Xha Gorioi
- Votreni

Pyetja 59.

Dallon nga veprat e tjera të Balzakut për gjerësinë e sfondit shoqëror në të cilin zhvillohet veprimi:

- Kushërira Betë
- Iluzionet e humbura
- Xha Gorioi
- Evgjëni Grande

Pyetja 60.

Balzaku arrin të na japë idenë e vazhdimësisë së dukurive shoqërore sepse:

- jeta e personazheve nuk mbaron me mbarimin e një romani
- ai përfshin një shtresë të caktuar sociale në rrëfim
- trajtat e mbinjeriut përcjellin mesazhe përgjithësuese
- gjuha simboliko-alegorike kërkon lexues aktiv

Pyetja 61.

Në bazë të romanit Lufta dhe Paqja është:

- bota mitologjike
- Rusia e fillimshkullit XX
- një ngjarje e madhe historike
- familja e Bollkonskëve

Pyetja 62.

Ana Karenina është personazh:

- tragjik
- humanist
- kritik
- ekzistencialist

Pyetja 63.

Është shkrimtar realist:

- Pushkini
- Hajne
- Tolstoi
- Flober

Pyetja 64.

Sipas studiuesve të Floberit gremina që ndan ëndrrën nga realiteti quhet:

- tragjizëm
- bovarizëm
- verizëm
- humanizëm

Pyetja 65.

Shpirtra të vdekur të Gogolit dhe Don kishoti i Servantesit janë:

- romane epike
- romane satirike
- traktate politike
- proza simbolike

Pyetja 66.

Peshën kryesore të strukturës romanore të *Shpirtra të vdekur* e mban:

- Pushkini
- Nozdrjovi
- Çiçikovi
- Koroboçka

Pyetja 67.

Personazhet e Gogolit veprojnë në:

- një qytet të Francës
- një mjedis social konkret
- një qytet imagjinar
- një ambjent të izoluar

Pyetja 68.

E. Allen Poe bashkohet me Bodlerin në parimin:

- e veprës letrare me përmbajtje
- e historizmit në letërsi
- e artit për art
- edukativ të artit

Pyetja 69.

Për Edgar Ponë objekt i poezisë është:

- e Bukura
- e Shëmtuara
- e përditshmja
- shpirti njerëzor

Pyetja 70.

Korbi në poezinë me titull Korbi të Posë është:

- metonimi
- personifikim
- simbol
- epitet

Pyetja 71.

Në vargjet popullore: “Përkulet qeparisi nga maja në rrëzë,

Po qan vasha mbi varrin e trimit”, është përdorur:

- antiteza
- metafora
- personifikimi
- paralelizmi figurativ

Pyetja 72.

Për Bodlerin poezia mund të jetë:

- e bukur nga përmbajtja dhe nga forma
- e bukur nga forma pa pasur asnjë lloj përmbajtje
- e bukur nga përmbajtja
- pa formë dhe pa përmbajtje

Pyetja 73.

Poezia e Bodlerit përcjell më shumë:

A.veprim

- objekte
- gjendje
- situata

Pyetja 74.

Për Bodlerin poezia duhet të jetë:

- impersonale
- dramatike
- objektive
- absurde

Pyetja 75.

Për Bodlerin mes kategorisë estetike të së bukurës dhe kategorisë morale të së keqes ka marrëdhënie:

- plotësie

- varësie
- ciklike
- kundërshtie

Pyetja 76.

Bodleri është poet i:

- natyrës
- dashurisë
- kozmosit
- së drejtës

Pyetja 77.

Lulet e së keqes transmeton shumë:

- imazhe
- moral
- ngjarje
- karaktere

Pyetja 78.

“Lakmia për pushtet” është në qendër të veprës:

- Hamleti
- Mbreti Lir
- Ëndrra e një nate vere
- Makbethi

Pyetja 79.

Cilësohet si jashtëzakonisht ambicioz:

- Makbethi
- Zonja Makbeth
- Banko
- Mbreti Dunkan

Pyetja 80.

Një nga vlerat e Shekspirit si dramaturg është:

- krijimi i dramës psikologjike
- gjuha e pasur
- krijimi i dramës moderne
- ndërtimi i strukturave të ndërlikuara të veprave

Pyetja 81.

Ngjarje të Skocisë mesjetare të shek. XI janë vendosur në veprën:

- Romeo dhe Xhuljeta
- Makbethi
- Shumë zhurmë për asgjë
- Hamleti

Pyetja 82.

Vepra e Shekspirit përcjell mesazhe të forta:

- humaniste
- romantike
- iluministe
- avanguardiste

Pyetja 83.

Hamleti, në veprën *Hamleti* të Shekspirit karakterizohet nga:

- qendrueshmëria
- dilema
- tradhtia
- lakmia

Pyetja 84.

“Krimi i trefishtë” është tipar për:

- Romeo
- Makbethin
- Hamletin
- Mbreti Lir

Pyetja 85.

Mishërojnë linjën e dashurisë çiftet:

- Makbeth - Zonja Makbeth
- Kordelja – Lir
- Horac – Ofeli
- Hamlet – Ofeli

Pyetja 86.

Mbreti Lir hyn në grupin e:

- komedive klasike
- tragjedive mbretërore
- dramave të dashurisë
- tragjedive antike

Pyetja 87.

Figura e Mbretit Lir spikat për:

- Karakter kontradiktor
- karakter të qendrueshëm
- idetë revolucionare
- tradhëti dhe hakmarrje

Pyetja 88.

Romeo dhe Zhuljeta janë personazhe:

- Hyjnorë
- fatalë
- pasivë
- Ateistë

Pyetja 89.

Romeo dhe Zhuljeta udhëhiqen nga:

- frika
- e vërteta
- pasioni
- urrejtja

Pyetja 90.

Historia e Romeos dhe Zhuljetës është kthyer në:

- mit
- histori
- absurd
- instikt

Pyetja 91.

Kanë njohur realizime të shumta në kinematografi dhe arte të tjera veprat e:

- Kamysë
- Bodlerit
- Shekspirit
- Anakreontit

Pyetja 92.

Komedia Hyjnore u shkrua me strofa që shkruhen:

- triolet
- sonet
- tercinë

- katrenë

Pyetja 93.

Komedia Hyjnore e Dantes përbëhet nga:

- 2 pjesë
- 3 pjesë
- 4 pjesë
- 12 këngë

Pyetja 94.

Komedia Hyjnore është shkruar në:

- latinisht
- spanjisht
- italisht
- greqisht

Pyetja 95.

Komedia hyjnore është shkruar në masa metrike:

- 11-rrokëshe
- 10-rrokëshe
- 16-rrokëshe
- 8-rrokëshe

Pyetja 96.

Komedia Hyjnore:

- nuk ka strukturë
- ka mungesë fabulore
- ka strukturë të përkryer
- nuk ka përmbajtje

Pyetja 97.

Cila nga veprat ka shtresim të fortë simboliko-alegorik:

- Eugjen Onjegini
- Viti '93
- Lufta dhe paqja
- Komedia Hyjnore

Pyetja 98.

Romani *Don Kishoti i Mançes* është një:

- roman kalorsiak

- rrëfim tragjikomik për dashurinë
- parodi e romaneve kalorsiake
- roman sentimental

Pyetja 99.

Don Kishoti është një figurë:

- qesharake
- tragjike
- mitologjike
- Heroike

Pyetja 100.

Nëse Don Kishoti idealizon realitetin Sanço Panço:

- mohon realitetin
- është fisnik
- është pragmatik
- Është luftarak

Pyetja 101.

Don Kishoti i Mançes i Servantesit i përket:

- Rilindjes angleze
- humanizmit italian
- Rilindjes spanjolle
- Romantizmit spanjoll

Pyetja 102.

Vemendja e Zvevos përqendrohet te:

- psikologjia e individit
- forca e popullit
- aparati shkencor
- marrëdhëniet familjare

Pyetja 103.

Rrëfimi i I. Svevos sillet rreth:

- kulturave pagane
- lirisë së njeriut
- botës natyrore
- integriteteve kulturore

Pyetja 104.

Personazhet e Svevos janë:

- aktivë
- optimistë
- të plogët
- socialë

Pyetja 105.

Ndërgjegjia e Zenos është vepër e:

- Xhojsit
- Folknerit
- Buxatit
- Zvevos

Pyetja 106.

Raportet e njeriut me kohën janë në qendër të romanit:

- Shkretëtira e tartarëve
- Një dashuri
- Kolombreja
- Libri i llullave

Pyetja 107.

Konstante artistike e veprave të Buxatit është:

- deti
- fusha
- mali
- vullkani

Pyetja 108.

Përfaqëson estetikën e absurdit:

- Kafka
- Beket
- Kamy
- Xhojsi

Pyetja 109.

Vendi i veprimit në dramën *Në pritje të Godosë* është:

- shtëpia
- zyra
- udha
- stacioni i trenit

Pyetja 110.

Estetika e përmbysur është tipar i:

- Lorkës
- Beketit
- Gogolit
- Gëtes

Pyetja 111.

Fausti i Gëtes është:

- poemë epike
- tragjedi
- dramë realiste
- roman kalorsiak

Pyetja 112.

Flitet për krijimin në “epruvetë” të Homonculusit të:

- Makbethi
- Komedia Hyjnore
- Fausti
- Ifigjenia në Aulidë

Pyetja 113.

Lëvizja Stuhi dhe Vrull (Sturm and Drang) është pjesë e:

- romantizmit gjerman
- realizmit evropian
- neoklasicizmit
- simbolizmit francez

Pyetja 114.

Romani *Vuajtjet e Verterit të ri* është i:

- Volterit
- Rilkes
- Gëtes
- Pasternakut

Pyetja 115.

Fausti i Gëtes dallon për:

- përzierjen e formave dramatike me atë epike e lirike
- rrëfimin realist sipas rendit të veprimeve
- respektimin e parimeve klasiciste

- estetikën e përmbysur

Pyetja 116.

Kështjella e Kafkës është:

- tregim
- novelë
- roman
- Dramë

Pyetja 117.

Modeli i njeriut të vogël, të shtypur nga makina burokratike është një nga leximet e veprave:

- Në pritje të Godosë
- Procesi
- Zonja Bovari
- Shpirtra të vdekur

Pyetja 118.

Personazhet e Kafkës janë:

- fjalorë pa faj
- kriminelë
- të sëmurë psikikë
- të gjymtuar

Pyetja 119.

Kamy është shkrimtar:

- romantik
- realist
- simbolist
- ekzistencialist

Pyetja 120.

Murtaja e Kamysë është shkruar në zhanrin e:

- letërkëmbimit
- kronikës
- udhëpërshkrimit
- farsës

Pyetja 121.

Absurdi dhe alegoria janë në thelb të rrëfimit të:

- Murtajës

- Të mjerët
- Këngëve të Çajld Haroldit
- Lulet e së keqes

Pyetja 122.

Sartri është shkrimtar dhe:

- mjek
- filozof
- arkitekt
- kompozitor

Pyetja 123.

Krijimtaria e Sartrit dallon për:

- heroin pozitiv
- poetikën natyraliste
- gjendjen e neverisë
- mbështetjen në paganizëm

Pyetja 124.

Neveria e Sartrit është:

- studim filozofik
- vëllim me tregime
- dramë
- roman

Pyetja 125.

Është shkrimtar ekzistencialist:

- Kafka
- Sartri
- Lorka
- Leopardi

Pyetja 126.

Ulisi i Xhojsit është analog me:

- Odisenë e Homerit
- Iliadën e Homerit
- Faustin e Gëtes
- Jozef K. E Kafkës

Pyetja 127.

Leopold Blumi është personazh i:

- Murtajës
- Ulksit
- Kështjellës
- Procesit

Pyetja 128.

Është tipar i narracionit të Ulksit të Xhojsit:

- përroi i ndërgjegjes
- E bukura absolute
- filozofia budiste
- kërkimi i të amshuarës

Pyetja 129.

Ngjarjet në romanin *Ulksi* zhvillohen në:

- 1 vit
- 1 orë
- 100 vjet
- 1 ditë

Pyetja 130.

Romancat cigane e Lorkës dallon për:

- Eros dhe thanatos
- erotikën cigane
- rrëfim ekzotik
- dramën e individit

Pyetja 131.

Romancat cigane është:

- vëllim poetik
- dramë
- roman
- poemë epike

Pyetja 132.

Në poezinë e Lorkës dallohet linja:

- letraro-folklorike
- mitiko-folklorike
- eksperimentale
- të trija mundësitë e shënuara

Pyetja 133.

Imazh kyc i poezisë së Eliotit është:

- dyluftimi kalorsiak
- toka e shkretë
- natyra baritore
- arkitektura e Romës

Pyetja 134.

Miti i Gralit të shenjtë shfrytëzohet te:

- Procesi
- Shkretania
- Muratja
- Në pritje të Godosë

Pyetja 135.

Te *Shkretania* e Eliotit mbizotërojnë:

- marrëdhëniet erotike
- gjendjet apokaliptike
- peizazhet romantike
- tablotë heroike

Pyetja 136.

Me Doktor Zhivagon Pastërnaku paraqiti:

- Absurditetin dhe mizorinë e Luftës Civile
- historinë ruse të shek. XVII
- misionin e pamundur të psikoanalistit
- një histori të fortë dashurie

Pyetja 137.

Doktor Zhivago i Pasternakut i përket:

- letërsisë moderne franceze
- letërsisë ruse të shek. XIX
- letërsisë ruse të shek. XX
- modernizmit gjerman

Pyetja 138.

Huazimi i formave poetike në ato rrëfimtare është tipar dallues për romanin:

- Shkretëtira e tartarëve
- Doktor Zhivago

- I huaji
- Procesi

Pyetja 139.

Cilën nga këto revista themeloi F. Konica:

- Flamuri i Arbërit
- Dituria
- Albania
- Leka

Pyetja 140.

Vepra epike karakterizohet nga:

- shprehja e drejtpërdrejtë e unit të autorit
- fshehja e autorit pas personazheve
- rrëfimi i autorit a i personazhit
- ligjërimi në vetë të dytë

Pyetja 141.

Vepër me parime të estetikës ka botuar:

- Poradeci
- De Rada
- Camaj
- Çajupi

Pyetja 142.

Në Letërsinë Shqipe të Rilindjes mbizotëroi:

- poezia
- drama
- romani
- tragjedia

Pyetja 143.

Marin Barleti është autor me prirje:

- humaniste
- Iluministe
- klasiciste
- racionaliste

Pyetja 144.

Panteizmi në krijimet e N. Frashërit është me natyrë:

- filozofiko-fetare
- erotike
- patriotike
- politike

Pyetja 145.

Është koncept i Lasgushit për dashurinë:

- materialiteti
- nihilizmi
- bipolariteti
- idealizmi

Pyetja 146.

Rrëfimi i Kutelit ka të bëjë me:

- rrëfimin alegorik
- rrëfimin si koncept religjioz
- rrëfimin për ngjarjen
- rrëfimin popullor

Pyetja 147.

Romani *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* mbështetet në:

- thurjen dramatike
- figurën e ironisë
- tonet lëvduese
- përfundimet moralizuese

Pyetja 148.

Krijimtaria e De Radës u realizua në marrëdhënie të ngushtë me:

- letërsinë e vjetër shqipe
- letërsinë italiane
- letërsinë natyraliste
- letërsinë gojore arbëreshe

Pyetja 149.

Vepra "Odin Mondvalsen" është ndërtuar si:

- rrëfim në vetën I
- rrëfim në vetën III
- rrëfim sipas modelit biblik
- rrëfim popullor

Pyetja 150.

14 vjeç dhëndër është:

- komedi politiko-shoqërore
- Traktat socio-psikologjik
- komedi realiste e zakoneve

D poemë satirike

Pyetja 151.

Themeluesi i prozës moderne shqipe është:

- Kadare
- Koliqi
- P. Marko
- - Pashku

Pyetja 152.

Cila nga disiplinat e mëposhtme nuk është degë e shkencës së letërsisë:

- kritika letrare
- historia e letërsisë
- teoria e komunikimit
- teoria e letërsisë

Pyetja 153.

Cila nga figurat e mëposhtme është figurë e sintaksës:

- pasthirrma
- inversioni
- anafora
- ironia

Pyetja 154.

Cili nga llojet e mëposhtme nuk i takon poezisë lirike:

- oda
- himni
- epi
- elegjia

Pyetja 155.

Vëllimi poetik i L. Poradecit "Vallja e Yjeve" ka strukturë:

- lineare
- binare
- rrethore
- zinxhirore

Pyetja 156.

Cila nga veprat e Fishtës është tragjedi:

- Nji lule vjeshtet
- Lahuta e Malcis`
- Mrizi i Zanavet
- Juda Makabe

Pyetja 157.

Doda i novelës “Gjaku” të Koliqit vepron nën shtysat e:

- instiktit të shkatërrimit
- padijes së tij dhe të rrethit të tij (thanatos)
- urrejtjes për gjaksin
- kulturës jetësore të mjedisit

Pyetja 158.

Poezitë më personale të Migjenit mbajnë për titull:

- “Kangët e fundit”
- “Kangët e mjerimit”
- “Melodi e këputun”
- “Pak poezi”

Pyetja 159.

Çajupi shquhet për:

- ligjërim të drejtpërdrejtë
- gjuhën e tërthortë dhe lakonike
- gjuhën simbolike
- mënyrën si e përshkruan natyrën

Pyetja 160.

Elementë të psikanalizës dhe simbolizmit vërehen më hapur në veprën e:

- Naimit
- Koliqit
- Kutelit
- Fishtës

Pyetja 161.

Poezia e Agollit është poezi e:

- abstraksionit të thellë
- filozofisë optimiste jetësore

- leximeve filozofike
- heroit të dëshpëruar

Pyetja 162.

G. Hungareti ndikoi në krijimatinë e:

- Agollit
- Camajt
- Pashkut
- Kadaresë

Pyetja 163.

M. Eminesku ndikoi në krijimatinë e:

- Lasgushit
- Konicës
- P Markos
- Migjenit

Pyetja 164.

Struktura e veprës *Këngë të Milosaos* është:

- fragmentar
- rrethore
- eliptik
- e hapur

Pyetja 165.

Cila nga veprat e mëposhtme mbeti e papërfunduar:

- Qyteti i fundit
- Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit
- Rrathë
- Odin Mondvalsen

Pyetja 166.

Cili nga autorët e mëposhtëm krijoi sonete:

- Asdreni
- Serembe
- Lasgushi
- të tre autorët e shënuar

Pyetja 167.

Humanistët preferojnë:

- romantizmin
- klasicizmin
- paganizmin
- natyralizmin

Pyetja 168.

Kush nga autorët e mëposhtëm u ndikua më shumë nga folklori:

- Migjeni
- Fishta
- Konica
- Koliqi

Pyetja 169.

Gj. Fishta ka shkruajtur vepra:

- lirike
- epike
- dramatike
- të trija së bashku

Pyetja 170.

Në cilin nga poetët e mëposhtëm elementet autobiografikë zënë më shumë vend:

- Naimi
- Serembe
- L. Poradeci
- Migjeni

Pyetja 171.

Krijimtaria e Camajt u karakterizua nga faza:

- tradicionale
- moderne
- italiane
- të trija fazat e shënuara

Pyetja 172.

F. Konica dhe Koliqi i përkasin:

- fazës klasike të letërsisë shqipe
- letërsisë së Rilindjes
- letërsisë së sotme shqipe
- letërsisë moderne

Pyetja 173.

Tregime të moçme Shqiptare i Kutelit është:

- vëllim me novela
- roman
- vëllim me tregime të përkthyer
- përmbledhje dhe përshtatje popullore

Pyetja 174.

Cila nga figurat e mëposhtme haset më dendur në veprat e Kadaresë:

- antiteza
- metafora
- simboli
- litota

Pyetja 175.

Lumi i vdekur cilësohet si roman:

- klasik
- surrealist
- modern
- psikologjik

Pyetja 176.

Te *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* plaka Nicë përfaqëson:

- hakmarrjen
- personin e papërgjegjshëm
- kujtesën kolektive
- intelektualen e pavarur

Pyetja 177.

Cili nga autorët e mëposhtëm është edhe përkthyes:

- Barleti
- Poradeci
- Koliqi
- Konica

Pyetja 178.

Krijimtaria e cilit autor ngjan me atë të poetit italian G. Leopardi:

- De Radës
- Barletit
- Serembes
- Asdrenit

Pyetja 179.

Cila nga veprat e mëposhtme është shkruar me alfabet latin:

- Rituali roman
- Apologjia e Skënderbeut
- Çeta e profetëve
- të trija veprat e shënuara

Pyetja 180.

Cili nga autorët e mëposhtëm konsiderohet si mbledhësi i parë i folklorit tonë:

- F. Bardhi
- S. Dine
- Th. Mitko
- L. Matrënga

Pyetja 181.

Censura karakterizon shoqëritë:

- e hapura
- e lira
- totalitare
- primitive

Pyetja 182.

Cili nga personazhet i përket romanit *Lumi i vdekur*:

- Sulejman Tafili
- Andrea
- Xheladin Beu
- Kuragini

Pyetja 183.

Dikotomitë e tipit si pranverë-dimër, jetë-vdekje, e bardhë-e zezë, e bukur-e shëmtuar, e mirë-e keqe, e vërtetë-gënjeshtër, janë tipar i lirikës së

- Çajupit
- De Radës
- Asdrenit
- Naimit

Pyetja 184.

Soneti përbëhet nga:

- 2 strofa

- 3 strofa
- 4 strofa
- një numër i pacaktuar strofash

Pyetja 185.

Cili nga poetët e mëposhtëm ka varg auditiv:

- Poradeci
- M. Camaj
- Kadare
- Kuteli

Pyetja 186.

Në letërsinë e viteve 1910-1940 u lëvrua më shumë:

- drama
- proza e shkurtër
- poezia
- proza e gjatë

Pyetja 187.

Cili e lëvroi i pari esenë në historinë e letërsisë sonë:

- Migjeni
- Konica
- Kuteli
- Poradeci

Pyetja 188.

Në krijimtarinë e Migjenit është lëvruar kryesisht:

- tema heroike
- motivi i natyrës
- tema erotike
- tema sociale

Pyetja 189.

Krijimtaria e Konicës dallon për:

- stilin e përkryer
- frymën historike
- tiparin atdhetar
- mbështetjen mitologjike

Pyetja 190.

Motivet kryesore të krijimtarisë letrare të M. Kutelit janë:

- dashuria njerëzore deri në adhurim
- gjakmarrja
- shpërbërja shpirtërore e individit
- të trija së bashku

Pyetja 191.

Vepra e Konicës “Doktor Gjilpëra ...” është:

- prozë poetike
- roman historik
- shënime eseistike
- roman satirik

Pyetja 192.

Cila nga letërsitë preferon mesjetën:

- Humanizmi
- Realizmi
- Romantizmi
- Simbolizmi

Pyetja 193.

Konceptimi i dashurisë për Poradecin bazohet në binomin:

- gaz-helm
- dashuri-xheloz
- dashuri-lumturi
- ndarje-braktisje

Pyetja 194.

“Udha, toka, guri, bari, mali, zogu, brazda” janë fjalëkyçe të krijimtarisë së

- Asdrenit
- Agollit
- Poradecit
- Podrimës

Pyetja 195.

Karakteristike për romanin “Odin Mondvalsen” është:

- rrëfimi në vetën e tretë
- organizimi i subjektit shkak-pasoje
- mungesa e rrjedhës kronologjike të ngjarjeve
- tema e dashurisë

Pyetja 196.

Vëllimi i Naimit *Lulet e verës* i përket gjinisë:

- lirike
- dramatike
- epike
- epiko-lirike

Pyetja 197.

Romantizmi arbëresh zë fill me:

- Lekë Matrengën
- Zef Seremben
- De Radën
- Jul Varibovën

Pyetja 198.

Nëntitulli “përrallë” i veprës *Doktor Gjilpëra* të Konicës lidhet me:

- autobiografinë e autorit
- ndërthurjen e ngjarjes së mundshme me të pamundshmen
- ndërhyrjen e redaksisë
- të treja së bashku

Pyetja 199.

Heroi kryesor të *Lahuta e Malcis* është:

- Oso Kuka
- Ora e Shqipërisë
- Tringa
- populli

Pyetja 200.

Prostitutën si figurë sociale e solli në letërsinë shqipe:

- Kadare
- Migjeni
- P. Marko
- Kuteli

Pyetja 201.

Apologjia e Skënderbeut është vepër e letërsisë

- së Rilindjes Kombëtare
- së vjetër
- së Pavarësisë

- moderne

Pyetja 202.

Cila nga figurat e mëposhtme haset më dendur te *Lahuta e Malcis*:

- simboli
- paradoksi
- hiperbola
- alegoria

Pyetja 203.

Cili nga autorët e mëposhtëm shkruajti për Skënderbeun:

- De Rada
- M. Barleti
- N. Frashëri
- të tri autorët e shënuar

Pyetja 204.

Cila nga poemat e mëposhtme është cilësuar si Iliada shqiptare:

- Historia e Skënderbeut
- Këngët e Milosaos
- Kënga e Sprasme e Balës
- Lahuta e Malcis

Pyetja 205.

Romantikët e letërsisë sonë lëvruan më shumë temën:

- sociale
- filozofike
- erotike
- patriotike

Pyetja 206.

Xheladin Beu në prozën e Kutelit përfaqëson:

- feudalin
- hakmarrësin
- fshatarin
- kaçakun

Pyetja 207.

Simbolistët në krijimet e tyre preferojnë përdorimin e:

- aliteracionit

- paralelizmit figurativ
- simbolit
- metonimisë

Pyetja 208.

Çajupi dallon në Letërsinë e Rilindjes për:

- poezinë epike
- humorin e satirën
- lirikën
- melankolinë

Pyetja 209.

Bukuria është pjesë e vëllimit:

- Lulet e verës
- Historia e Skënderbeut
- Qerbelaja
- Fletore e bektashinjve

Pyetja 210.

Humanizmi është tipar i prozës së:

- P. Markos
- De Radës
- Kadaresë
- Bodlerit

Pyetja 211.

Bagëti e bujqësi e Naimit ngjan me:

- Jeta e Re
- Mili dhe Hajdhia
- Soditjet
- Bukolikë dhe Gjeorgjikë

Pyetja 212.

Cila nga veprat ka bazë mitologjike, folklorike dhe historike:

- Tregime të moçme shqiptare
- Skanderbeku i pafan
- Lahuta e Malcis
- Gjanomadhe e Gjatollinj

Pyetja 213.

Rrëfimi në vetë të tretë është më së shumti tipar i shkrimtarëve:

- klasiciste
- moderne
- romantike
- realiste

Pyetja 214.

“Tipiken dhe tipizimin letrar” e hasim te:

- Kështjella
- Rrathë
- Plaku dhe deti
- Lumi i vdekur

Pyetja 215.

Ligjërimi në vetë të parë është tipar dallues i krijimtarisë:

- realiste
- humaniste
- moderne
- klasiciste

Pyetja 216.

Sa gjini letrare dallohen teorikisht:

- 2
- 4
- 3
- shumë

Pyetja 217.

Në vargun e Migjenit “Kafshatë që s'kapërdihet asht or vlla mjerimi...” është përdorur:

- inversioni
- aliteracioni
- pyetja retorike
- epiteti

Pyetja 218.

Vargjet e Asdrenit: “Lulqkuqeja e mjera A
Asgjékundi s’ka shtëpi B
e shkonjëtën nd'arrati; B
ajo s’është si të tjera A

S’ka stoli”, kanë rimë:

- të kryqëzuar
- të përsëritur
- të puthur
- të anasjelltën

Pyetja 219.

Letërsia dallon nga artet e tjera nga:

- paraqitja e realitetit
- funksioni estetik
- gjuha e figurshme
- funksioni njohës

Pyetja 220.

Vjershat lirike që përshkruajnë peizazhe natyrore me elementë të jetës fshatare e baritore quhen:

- idile
- himne
- ode
- epigrame

Pyetja 221.

Si formë tregimtare “objektive” cilësohet:

- lirika
- epika
- dramatika
- satirika

Pyetja 222.

Melodizmi është përgjithësisht tipar i:

- romanit epike
- dramës klasike
- poezisë lirike
- teatrit të absurdit

Pyetja 223.

Vepra, lexuesi janë të domosdoshme për:

- komunikimin letrar
- strukturën e veprës
- përcaktimin e tregimtarit
- vetëm për lexuesin

Pyetja 224.

Poezi kozmogonike ka krijuar:

- Fishta
- Poradeci
- Koliqi
- Agolli

Pyetja 225.

Hero romantik është:

- Juda Makabë e Fishtës
- Elen Qerimi i Kadaresë
- Milosao i De Radës
- Nushi i Migjenit

Pyetja 226.

Simbolika është tipar i tregimtarisë së:

- Koliqit
- Agollit
- Kutelit
- P. Markos

Pyetja 227.

Revista “Fjamuri i Arbërit” (1885) është themeluar nga:

- De Rada
- Konica
- Koliqi
- Asdreni

Pyetja 228.

Cila nga veprat e mëposhtme të Kadaresë është roman:

- Autobiografia e popullit tim në vargje
- Përbindëshi
- Dialog me Alen Boskenë
- Emblema e dikurshme

Pyetja 229.

Vepra e përkthyer nga Koliqi titullohet:

- Poetët e mëdhenj t'Italisë
- Rubairat
- Shtëpia e kukullave
- Hamleti

Pyetja 230.

Në cilën vepër të Kadaresë është vendi me emrin “sokaku i të marrëve”:

- Kështjella
- Piramida
- Pallati i ëndërrave
- Kronikë në gur

Pyetja 231.

Mospërzierja e tragjikes me komiken është karakteristike për:

- klasicizmin
- realizmin
- romantizmin
- simbolizmin

Pyetja 232.

Loja me kohën dhe hapësirën është tipar i prozës së:

- P. Markos
- J. Xoxës
- Trebeshinës
- - Podrimës

Pyetja 233.

Simbolizmi si shkollë letrare lindi në:

- Itali
- Angli
- Gjermani
- Francë

Pyetja 234.

Pasqyrat e Narçizit e Koliqit është:

- poemë
- prozë poetike
- tregim
- novelë në vargje

Pyetja 235.

Cili nga autorët shkëlqen në lirikën erotike:

- Camaj
- Skiroi

- Poradeci
- Serembe

Pyetja 236.

Lirika erotike e Naimit dallon për:

- realizëm
- sensualizëm
- platonizëm
- modernizëm

Pyetja 237.

“Bota jepet në zhvillim, në ndryshim, në evoluim të pandërprerë. Kjo prirje lidhet me zbulimin e shkaqeve e të pasojave të dukurive jetësore”. Është parim krijues i:

- sentimentalizmit
- realizmit
- romantizmit
- klasicizmit

Pyetja 238.

Adhurojnë dhe imitojnë botën antike, veçanërisht në lëvrimin e temave universale

- klasicistët
- iluministët
- humanistët
- modernistët

Pyetja 239.

Krijimtaria e cilit autor ka mjaft të dallueshme shtresën mitologjike:

- Agollit
- Kadaresë
- Xoxës
- Kutelit

Pyetja 240.

Dallohet për neologjizma në prozën e tij:

- Kadare
- Agolli
- Trebeshina
- Pashku

Pyetja 241.

Proza e Koliqit “Gjaku” është:

- roman
- novelë
- tregim
- prozë poetike

Pyetja 242.

Doktor Gjilpëra në veprën e Konicës cilësohet si personazh

- egoist
- historik
- autobiografik
- profesionist

Pyetja 243.

Histori e Skënderbeut e Barletit është vepër:

- dramatike
- historike
- historiko-letrare
- letrare

Pyetja 244.

Cili nga autorët dallohet në lirikën erotike për altruizëm:

- De Rada
- Skiroi
- Poradeci
- Koliqi

Pyetja 245.

Cila nga poezitë e Poradecit konsiderohet si çelës i poetikës së këtij autori:

- Vdekja e Nositit
- Zog i qiejve
- Poradeci
- Prej çdo gazi e hidhërimi

Pyetja 246.

I kushtojnë rëndësi përmbajtjes së veprës:

- realistët
- futuristët
- simbolistët
- modernistët

Pyetja 247.

Salembosa, Protagoras Dhalla janë personazhe të:

- Çajupit
- Kutelit
- Fishtës
- Konicës

Pyetja 248.

Janë vepra simboliko-alegorike:

- Lirika mes dy moteve
- Kronikë në gur
- Pallati i ëndrrave
- Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo

Pyetja 249.

E konceptoi lirikën erotike në nivelin folklorik dhe atë autorial:

- P. Marko
- Çajupi
- I. Kadare
- Serembe

Pyetja 250.

Ngjarjet te vepra *Lahuta e Malcis* përfshijnë kufijtë kohorë:

- 1912-1944
- 1944-1970
- 1800-1878
- 1878-1913

Pyetja 251.

Migjeni është shkrimtar:

- realist dhe simbolist
- humanist
- romantik
- klasik

Pyetja 252.

Romani modern parashikon dhe kërkon një lexues:

- pasiv
- asnjans
- aktiv

- joelitar

Pyetja 253.

Shtresimi kryesor te *Lumi i vdekur* është ai:

- social
- psikanalitik
- filozofik
- individual

Pyetja 254.

Në cilin nga romanet satirizohet paaftësia e drejtuesve dhe madhështia e tyre e rreme:

- Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo
- Pallati i ëndërrave
- Kështjella
- Shkaba

Pyetja 255.

Pse në Kosovë poezia bashkëkohore ka qenë larg tekstit të qartë e të kuptueshëm, duke u berë hermetike:

- sepse kështu donin poetët
- sepse kjo lloj poezie është më e bukur
- për shkak të censurës
- të trija mundësitë e shënuara

Pyetja 256.

“Helioterapia” që mbron Dr. Gjilpëra synon në:

- përdorimin e medikamenteve të vendeve perëndimore
- mospërdorimin e medikamenteve
- kujdesin shëndetësor sipas ligjeve natyrore të njerëzve për t’mos u sëmurë
- vizitat dhe terapitë periodike të pacientëve

Pyetja 257.

“Zemra e jetës” është cikël poetik i:

- Asdrenit
- Camajt
- Agollit
- Poradecit

Pyetja 258.

Preferon natën në krijimtarinë prozaike:

- Kuteli
- Koliqi
- Konica
- Fishta

Pyetja 259.

“Breshka, gjarpri, bjeshka, fyelli, guri” janë çelësa poetikë të:

- Podrimes
- Camajt
- Poradecit
- Kadaresë

Pyetja 260.

Në përshkrimin e vashës N. Frashëri përdor figura artistike (epitete, krahasime, metafora) qiellore a hyjnore. Kështu bën edhe:

- Migjeni
- De Rada
- Kuteli
- Poradeci

Pyetja 261.

Cili nga autorët nuk e përshkruan fizikisht dashurinë:

- Poradeci
- Çajupi
- Naimi
- Asdreni

Pyetja 262.

Në letërsinë shqipe përdori i pari vargun e lirë:

- Migjeni
- Asdreni
- Çajupi
- Naimi

Pyetja 263.

Elementet psikanalitikë në prozën *Kumbulla përtej murit* lidhen me filozofinë e teorinë

- niçiane
- kantiane
- frojdiane
- shopenhauriane

Pyetja 264.

Tringa e Lahutës së Malcis është e ngjashme me:

- motrën e Gjergj Elez Alisë
- Vojsavën
- Ajkunën
- të shoqen e Halilit

Pyetja 265.

Janë “proza subjektive” ose “poema në prozë:

- Vargjet e lira
- Novelat e qytetit të veriut
- Skicat letrare
- Gjanomadhë e Gjatollinj

Pyetja 266.

Cili nga poetët shqiptarë e solli lirikën filozofike në formën e një sistemi të plotë:

- Poradeci
- Adreni
- Naimi
- Fishta

Pyetja 267.

Vargjet: “Të krehur mirë flokët ve si rreth

Gërshetin që shkëlqen krejt në të zi

Dhe balli lëshon rreze drite shkrep

Si grykë e detit agut plot freski”, krijojnë:

- portretin e vashës me enumeracione e krahasime folklorike
- imazhin e largimit të vashës
- lindjen e dashurisë
- lumturisë familjare

Pyetja 268.

Nëse dashuria për Naimin është hyjnore, për Çajupin është:

- ideale
- qiellore
- tokësore
- e barabartë me lirinë

Pyetja 269.

“Perëndim, mjerim, fund, hije e trazueme, dhimbë krenore” janë çelësa poetikë të:

- Koliqit
- Xoxës
- Mjedës
- Migjenit

Pyetja 270.

Trajtat e mbinjeriut në krijimtarinë e Migjenit lidhen me filozofinë:

- iluministe
- niçiane
- kantiane
- psikanalitike

Pyetja 271.

Këmbanat e Krujës është:

- poemë epike
- dramë
- vëllim poetik
- poemë liturgjike

Pyetja 272.

Lloji i prozës që përshkruan familjen (model) dhe historinë e saj quhet:

- baladë
- tregim
- mit
- sagë

Pyetja 273.

Është mishërim i njeriut të emancipuar, humanizmit dhe intelektualit që do t'i shërbejë atdheut:

- Dr. Protagora
- Dr. Gjilpëra
- Dr. Ermullahu
- Gaspër Tragaçi

Pyetja 274.

Mili dhe Haidhia është vepër:

- idilike
- baritore
- bukolike
- thjesht humaniste

Pyetja 275.

Cili nga romancierët shqiptarë ka pika takimi me të ashtuquajturën letërsi e brezit të humbur”:

- Xoxe
- Pirandelo
- Trebeshina
- P. Marko

Pyetja 276.

Në vargjet e Migjenit:

“Kafshat që s’kapërdihet asht, or vlla mjerimi, / Kafshat që të mbet në fyt e të zë trishtimi”, është përdorur:

- simboli
- metonimia
- personifikimi
- paradoksi

Pyetja 277.

“... A mund ta shikonte përsëri të mbuluar me një çarçaf të bardhë! ... Oh! ... Sa larg që ishte Danimarka!...”. Me citimin e mësipërm përfundon vepra:

- Qyteti i fundit
- Odin Mondvalsen
- Rrathë
- Pallati i ëndërrave

Pyetja 278.

Bëhet bartës e shprehës i dukurisë së metempsikozës:

- Asdreni
- Naimi
- Serembe
- Skiroi

Pyetja 279.

E vlerësuan folklorin dhe patën marrëdhënie të ngushta me të:

- klasicistët
- simbolistët
- humanistët
- romantikët

Pyetja 280.

Hilush Vilza e Gaspër Tragaçi përfaqësojnë:

- njeriun pasiv

- dy mendësi të ndryshme
- karakterin e paythyeshëm
- shpirtin luftarak

Pyetja 281.

Tipari arkitekturor i “Pallatit të ëndërrave” të Kadaresë ngjan me:

- Mbreti Lir të Shekspirit
- Komedinë hyjnore të Dantes
- Prometeun e Eskilit
- Komedinë njerëzore të Balzakut

Pyetja 282.

Është tregim në kufi të përrallës me legjendën:

- Kërcimtarja e Dukagjinit
- Gjaku
- Bylbylat e Plepishtit
- Diloca

Pyetja 283.

Është pagëzuar si “epiku më i madh i shekullit”:

- Fishta
- De Rada
- Naimi
- Barleti

Pyetja 284.

Zullutë, Plugu, Denizullu janë personazhe të:

- Konicës
- Koliqit
- Kutelit
- Fishtës

Pyetja 285.

Cili nga poetët e mëposhtëm ka ndikim nga poezia lindore.

- Kuteli
- Noli
- Naimi
- Asdreni

Pyetja 286.

Është ndikuar nga E. Heminguej:

- Kadare
- Marko
- Kafka
- Fishta

Pyetja 287.

Oraliteti është tipar i poezisë së:

- Migjenit
- Koliqit
- Fishtës
- Camajt

Pyetja 288.

Lahuta e Malcis përbëhet nga:

- 24 këngë
- 30 variante
- 30 këngë
- 15 pjesë

Pyetja 289.

“Parathanja e Parathanjëve” hap vëllimin poetik:

- Vallja e yjeve
- Vargje të lira
- Mrizi i Zanavet
- Gjurmat e stinëve

Pyetja 290.

Mbi cilin personazh bie mallkimi hyjnor “dënimi me jetë të përjetshme”:

- Xheladin Beu
- Tat Tanushi
- Akili
- Oso Kuka

Pyetja 291.

Cila nga poezitë e Fishtës ka karakter vetërrëfimi dhe sintetizon idetë e lirikave të mëparshme:

- Gjuha shqype
- Nji lule vjeshtet
- Surgitë, mortui (çohi te dekun!)
- Shqypnija

Pyetja 292.

Cili nga vëllimet strukturohet në 7 pjesë e secila prej tyre ruan elementin këngë:

- Vargjet e lira
- Vallja e yjeve
- Lahuta e Malcis
- Ylli i zemrës

Pyetja 293.

Përfundimi tragjik i personazheve të poemës “Mili dhe Hajdhia” është tregues i:

- parimit romantik që dashuria pasionante bart embrionin e tragjizmit
- besimit popullor të autorit
- besimit në botën mitologjike
- prirjeve epike të veprës

Pyetja 294.

Janë këngët e entuziazmit, ekstazës, dëshirës e lulëzimit:

- Kangët e pakëndueme
- Kangët e ringjalljes
- këngët në vetë
- Kangët e rinisë

Pyetja 295.

Në vargjet e poezisë “Malli” të Poradecit:

“Syri-i bukur që t’u vrenjt
Syri yt që më lëndon
Do më lërë-a von a shpejt,
Do më lërë-a shpejt a von” është përdorur:

- anafora
- përsëritja
- epifora
- epanastrofa

Pyetja 296.

Bëjnë pjesë tek figurat e bukurtingëllimit (diksionit):

- aliteracioni
- asonanca
- onomatopeja
- të trija së bashku

Pyetja 297.

“Mosrespektimi i rendit të organizimit të fjalëve në fjali për të shkaktuar efekt të caktuar te lexuesi apo dëgjuesi”, është parimi i krijimit të figurave të:

- mendimit
- sintaksës
- diksionit
- të tropeve

Pyetja 298.

Narçizi te *Pasqyrat e Narçizit* është figurë:

- historike
- reale
- mitologjike
- imagjorative

Pyetja 299.

Në ndeshjen me gjaksin e vëllait të vet në Shkodër, Doda, pa menduar gjatë e vret gjaksin, i dorëzohet pushtetit dhe ndjen një lirim në thellësi të shpirtit - është pjesë e subjektivit të prozës:

- Studenti në shtëpi
- Diloça
- Gjaku
- Pasqyrat e Narcizit

Pyetja 300.

Qielli, dheu, ajri, zjarri janë elementë përbërës të poetikës së:

- Kutelit
- Migjenit
- Koliqit
- Poradecit

Pyetja 301.

Bylbylat e Plepishtit e Koliqit është:

- roman
- tregim
- novelë
- dramë

Pyetja 302.

Bashkohet me Kafkën, kur akuzon sistemet shoqërore totalitare e antinjerëzore:

- Agolli
- P. Marko
- Kadare
- Xhojsi

Pyetja 303.

Parimet e klasicizmit u shpallën në:

- “Arti poetik” i Bualoit
- “Çfarë është arti” e Tolstoit
- “Poetika” e Aristotelit
- “Sidi” i Kornejit

Pyetja 304.

Motivi kryesor në vëllimin *Vallja e yjeve* e L. Poradecit është motivi:

- kozmogonik
- i peisazhit
- erotik
- të tre së bashku

Pyetja 305.

Në librin *Tregtar flamujsh* Koliqi paraqet:

- realitetin e jetës shkodrane
- “Motin e Madh” të Skënderbeut
- historinë e malësorëve shqiptarë
- historinë shkodrane të viteve ‘60

Pyetja 306.

Cili do të ishte përcaktimi më i saktë për Asdrenin:

- pararendës i poezisë moderne shqiptare
- themelues i romantizmit shqiptar
- përfaqësues i prozës moderne
- përfaqësues kryesor i realizmit kritik

Pyetja 307.

Mesazhi kryesor i romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” është:

- ndëshkimi moral i shkaktarëve të luftës
- triumfi i së keqes në kohë luftrash
- vetësakrificimi i jetës në emër të idealit
- mohimi i luftës në emër të paqes

Pyetja 308.

Te "Pallati i ëndërrave" rrëfimi është:

- verist
- romantik
- realist
- simbolik

Pyetja 309.

"Lahuta e Malcis" e Fishtës është organizuar në:

- strofa
- pjesë
- këngë
- një tërësi të pandarë me mbi 16000 vargje

Pyetja 310.

Në vargjet e poezisë

"Një natë pa gjumë
Pak dritë! Pak dritë! O shok, o vëlla ...
Të lutem pak dritë!", është përdorur:

- personifikimi
- paralelizmi figurativ
- përsëritja
- simboli

Pyetja 311.

Në fjalinë e figurshme "Lexova Migjenin", "E bleva Kadarenë" është përdorur:

- krahasimi
- metafora
- simboli
- metonimia

Pyetja 312.

Mënyra e mosemërimit të drejtpërdrejtë të një personi të keq, një fatkeqësie, etj., sepse tingëllon vrazhdë e shëmtuar (psh. mbylli sytë, të marrtë e mira ...), përbën:

- litoten
- antitezën
- eufemizmin
- inversionin

Pyetja 313.

Vepra e parë origjinale në shqip është:

- Çeta e Profetëve
- Katekizmi i vogël

- Meshari
- Doktrina e krishterë

Pyetja 314.

Asdreni ngjason me Poradecin:

- në mënyrën e trajtimit të dashurisë
- në lëvrimin e prozës
- sepse të dy janë poetë tipikë romantikë
- sepse i dhanë një vend të veçantë poezisë së peizazhit

Pyetja 315.

Shkrimi elegjiak është tipar i prozës së Kutelit te:

- E madhe është gjëma e mëkatit
- Tregime të moçme shqiptare
- Vjeshta e Xheladin beut
- Qetësi përpara fërtyme

Pyetja 316.

Universaliteti, kontemporaniteti (bashkëkohësia) dhe koncentracioni janë parime poetike të:

- Lasgushit
- Mjedës
- Gëtes
- Podrimës

Pyetja 317.

“Arkaizmi estetik” dmth. vjetërimi i kohës, shtimi i distancës së poetit me ngjarjen e rrëfyer, mosangazhimi i drejtpërdrejtë i autorit, etj. është tipar i krijimtarisë së:

- Bogdanit
- Camajt
- Fishtës
- Koliqit

Pyetja 318.

Vlerat më të larta artistike Koliqi i shënoi në:

- prozë
- studime
- poezi
- përkthime

Pyetja 319.

Prirja hermetike e poezive të Camajt shfaqet në shkallën më të lartë në vëllimin:

- Palimpsest
- Lirikë mes dy motëve
- Një fyell ndër male
- Njeriu me vete e me të tjerë

Pyetja 320.

Në vargjet popullore: “Edhe ‘i nuse e paska zanë,
zanë e paska t’bin e krajlit”, përdoret:

- përsëritja
- epanastrofa
- inversioni
- retiçenca

Pyetja 321.

Tema fetare u lëvrua më shumë nga autorët e:

- letërsisë së vjetër
- letërsisë së pavarësisë
- Rilindjes Kombëtare
- letërsisë së pas viteve `90

Pyetja 322.

Ç’masë metrike përdori Budi si poet:

- 10-rrokëshin
- 8-rrokëshin
- 4-rrokëshin
- 11-rrokëshin

Pyetja 323.

“Dhënia e karaktereve të jashtëzakonshëm në mjedise të jashtëzakonshme” është tipar i:

- Humanizmit
- Romantizmit
- Rilindjes
- Lëvizjes stuhi dhe vrull

Pyetja 324.

Në vargjet e Lasgushit: “Vijnë vashat valle-valle
Gushë-e-gji-stolisura”, është përdorur:

- aliteracioni
- onomatopeja
- epifora

- asonanca

Pyetja 325.

Cilësohet si biografia poetike e Koliqit:

- Pasqyrat e Narçizit
- Bylbylat e Plepishtit
- Kërcimtarja e Dukagjinit
- Symfonija e Shqipevet

Pyetja 326.

Cili nga pohimet e mëposhtme i takon Serembes:

- është poet thellësisht antik e patriotik
- mbetet i vetmi poet modern ne poezinë arbëreshe
- ndikohet nga Leopardi e të tjerë romantikë evropianë
- të trija alternativat e shënuara

Pyetja 327.

Vargun 16-rrokësh në letërsinë shqipe e krijoi:

- Naimi
- Asdreni
- Çajupi
- Serembe

Pyetja 328.

Cili nga vlerësimet i takon poezisë së Camajt:

- është mjaft i kursyer nga ana vëllimore
- është maksimalisht sintetik, shpesh deri në kufijtë e aforizmave poetike
- është varg përgjithësisht i lirë, por poezitë kanë ritëm e muzikalitet të brendshëm
- të trija alternativat

Pyetja 329.

Dashuria është një linjë dytësore, madje hipotetike, dmth. pa arritur të sendërtohet në veprën:

- Rruga e Golgotës
- Odin Mondvalsen
- Vjeshta e Xheladin beut
- Studenti në shtëpi

Pyetja 330.

Proza poetike dallohet sepse ka elementë të:

- prozës

- ritmit të brendshëm
- poezisë
- të trija së bashku

Pyetja 331.

Është e ndarë në dy pjesë të dallueshme si për nga subjekti ashtu edhe për nga mënyra e ligjerimit:

- Pasqyrat e Narçizit
- Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit
- Pallati i ëndrrave
- Vjeshta e Xheladin beut

Pyetja 332.

Është figura që, me anë të tingujve, imiton fenomene akustike të ndryshme nga natyra, bota e kafshëve, njerëzit dhe fenomenet e tjera natyrore:

- asonanca
- epanalepsa
- paralelizmi figurativ
- onomatopeja

Pyetja 333.

“Është një rrëfim i lidhur me një ngjarje, që e ka zanafillën në kohët më të lashta dhe që lidhet me krijimin dhe prejardhjen e botës, me perënditë e ndryshme dhe besimet fetare, me krijimin e kombeve, gjuhëve, etj.”. Kështu përkufizohet:

- përralla
- fabula
- miti
- të treja së bashku

Pyetja 334.

Cili nga pohimet nuk është i vërtetë për “Pasqyrat e Narçizit”:

- përbëhet nga 7 pasqyra
- element kryesor është ai i pasqyrimit ose shëmbëllimit
- është prozë poetike
- u shkruajt në italisht

Pyetja 335.

Presimi i kohëve të ngjarjeve, këmbimet e befta të situatave e ngjarjeve, të kohëve e të hapësirës që kanë të pranishëm fragmentarizmin e parimin e kolazhit, rrëfimi me kahje vertikale, pasqyrimi i brendshëm i botës së personazheve, etj., janë tipare dalluese të krijimtarisë së:

- Trebeshinës

- Kutelit
- J. Xoxës
- të treve së bashku

Pyetja 336.

Cili nga pohimet e mëposhtme i takon M. Kutelit:

- vepra e tij ishte e ndaluar apo gjysmë e ndaluar dhe s'u botua e plotë deri në vitin nëntdhjetë
- Vjeshtha e Xheladin Beut është rrëfim mbi çmendurinë e diktatorit
- Tat Tanushi është rrëfim për shpëtimin e Krijuesit për të takuar përjetësinë
- të trija alternativat

Pyetja 337.

Në vargjet e poezisë “Vallja e luleve” të Poradecit:

“Vijnë vashat valle-valle

Gushëz-e-gji stolisura

Një pëllumb, një sysorkadhe ...”

efektet vizive e tingullore realizohen kryesisht përmes:

- neologjizmave
- huazimeve
- barbarizmave
- arkaizmave

Pyetja 338.

Bazën folklorike të krijimtarisë së tij M. Kuteli e mori nga:

- autorët e letërsisë së vjetër
- studimet në Bukuresht e Selanik
- folklori ynë
- autorët e Rilindjes

Pyetja 339.

Tringa dhe Patër Gjoni të “Lahuta së Malcis” klasifikohen si personazhe:

- historike
- autorialë
- mitologjike
- asnjëri prej këtyre

Pyetja 340.

“Dashuria” është krijim poetik i:

- De Radës
- Asdrenit
- Skiroit
- Varibovës